



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror
Kryesia e Kuvendit
P-044

Prishtinë, më 25 korrik 2022, ora 11:00 dhe 1 gusht 2022, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 25 KORRIK DHE 1
GUSHT 2022

E hënë, më 25 korrik 2022, ora 11:00

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Blerta Deliu-Kodra, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se nuk ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

Pastaj, kryetari në dakordim me nënkryetarët e Kuvendit dhe me përfaqësuesit e grupeve parlamentare të pranishëm, vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, të enjten, më 28 korrik 2022, të mbajë seancën e re plenare, ndërsa të premtën, më 29 korrik 2022, të mbajë vazhdimin e seancës plenare me pikat e papërfunduara më 21 korrik 2022, si në vijim:

I. Seanca e re plenare do të mbahet të enjten, më 28 korrik 2022, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-148 për ratifikimin e Marrëveshjes së Partneritetit për Kornizën Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për marrëveshjet për zbatimin e ndihmës financiare të Unionit për Kosovën në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA III),
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-151 për ratifikimin e marrëveshjes për financim të politikave zhvillimore për financa publike dhe rritje të qëndrueshme ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim,
6. Shqyrtimi i dytë i Projekt-rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-058 dhe ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 03/L-256
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rregullimin e çmimit të produkteve medicinale,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësinë dhe
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2021.

Me propozim të kryetares së GP të LVV-së, Mimoza Kusari-Lila, me njoftimin se komisionet funksionale do t'i procedojnë raportet para fillimit të seancës plenare, kryetari i radhiti në rendin e ditës të seancës së re plenare, pikat e lartshënuara me nr. 6 dhe 7.

Ndërsa, në lidhje me dy interpelancat, në dakordim me kryetarin e GP të AAK-së, Besnik Tahiri, në cilësinë e kërkuesit të interpelancave, ato mbeten për javën pasuese.

II. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara më 21 korrik 2022 do të mbahet të premtën, më 29 korrik 2022, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

10. Votimi i Propozim-rezolutës për adresimin e rritjes së çmimeve,
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2021,
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh. a. për vitin 2021,
13. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 12/84, datë 22 qershor 2022, për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës,
14. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 13/84, datë 22 qershor 2022, për hartimin e Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri",
15. Ratifikimi i anëtarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit,
16. Debat parlamentar në lidhje me mosliberalizimin e vizave nga BE-ja për Kosovën.

Kryetari e ndërpreu mbledhjen e Kryesisë në orën 11:39 minuta.

E hënë, më 1 gusht 2022, ora 11:00

Vazhdimi i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e filluar më 25 korrik 2022

Në mbledhje morën pjesë: Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit; Saranda Bogujevci, Enver Hoxhaj dhe Bekim Arifi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare në mbledhje morën pjesë: Mimoza Kusari-Lila, Eliza Hoxha, Armend Zemaj, Besnik Tahiri dhe Enis Kervan.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, Ismet Krasniqi, si dhe stafi përgjegjës në mbështetje të Kryesisë së Kuvendit.

Mbledhjen e drejtoi Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit.

Me propozim të kryetarit, Kryesia e Kuvendit e plotësoi rendin e ditës edhe me 22 pika për seancën e re plenare.

Pastaj, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme,
3. Përgatitjet për seancë të re plenare,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 15 korrik 2022

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 15 korrik 2022.

2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme

Kryesia, pas diskutimeve, vendosi që vazhdimi i dy seancave plenare me pikat e papërfunduara, të mbahet të mërkurën, më 3 gusht 2022, në orën 13:00, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 21 korrik 2022:

- 10. Votimi i Propozim-rezolutës për adresimin e rritjes së çmimeve,*
- 11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2021,*
- 12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh. a. për vitin 2021,*

13. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.12/84, datë 22 qershor 2022 për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës,
14. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.13/84, datë 22 qershor 2022 për hartimin e Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”,
15. Ratifikimi i anëtarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit,
16. Debat parlamentar në lidhje me mos liberalizimin e vizave nga BE-ja për Kosovën.

II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 28 dhe 29 korrik 2022:

9. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr.08/L-138 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë,
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2021.

Në lidhje me pikën e rendit të ditës me nr. 16 të lartshënuar të vazhdimin të seancës plenare, kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, paralajmëroi se në seancë plenare do të parashtrojë mocion procedural që debati parlamentar në lidhje me mosliberalizimin e vizave nga BE-ja për Kosovën të jetë pikë e parë e rendit të ditës më 3 gusht 2022.

Diskutimi i tij i plotë është dhënë në transkript.

3. Përgatitjet për seancë plenare të re të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme dhe pas diskutimeve, vendosi që seanca plenare e radhës e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbahet të enjten, më 4 gusht 2022, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për Masat e emergjencës në furnizimin e energjisë,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr.08/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr.08/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-041 për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-079 për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 02/L- 85 për peshkatari dhe akuakulturë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-080 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2003/5 i Kosovës për farërat,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-085 për Bujqësi Organike,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-082 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-084 për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 02/L-53 për gjuetinë,

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-085 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/13 për materialin fidanor,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-086 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-114 për pasurimin e miellit,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-087 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 04/L-040 për rregullimin e tokës,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-111 për bletari,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-089 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2003/10 për plehrat artificiale,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-090 për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 02/L-10 për përkujdesjen ndaj kafshëve,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-091 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/21 për veterinarinë,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-029 për Inspektoratin Bujqësor,
19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-093 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-042 i produkteve për mbrojtjen e bimëve,
20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-094 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr.02/L- 9 për ujitjen e tokave bujqësore,
21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-095 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/9 për kooperativat e bujqve,
22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën bujqësore,
23. Interpelancë me ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla, për çështjen: “Ligji i zyrtarëve publikë”,
24. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës,
25. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura,
26. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-049 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor,
27. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-050 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës,
28. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-122 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-058 dhe ligjin nr. 04/L-122 si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256,
29. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-028 për të drejtën ndërkombëtare private,
30. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-107 për Aktet Juridike,
31. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-149 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-010 për noterinë,
32. Shqyrtimi i Strategjisë së Sigurisë së Kosovës 2022-2027,
33. Zgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar,

34. *Shqyrtimi i rekomandimeve të dala nga shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2021 dhe raportit të auditimit të performancës “Menaxhimi i fondeve publike në Radiotelevizionin e Kosovës”,*
35. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave.*

Po ashtu, Kryesia në lidhje me formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave, nga pika nr. 35 e lartshënuar e seancës plenare më 4 gusht 2022, nxori edhe këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që në seancën plenare, më 4. 8. 2022, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shqiptar.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim:
 - GP i LVV-së, kryetarin (*i cili nuk duhet të jetë kryetar i ndonjë komisioni parlamentare*) dhe katër (4) anëtarë;
 - GP i PDK-së, dy (2) anëtarë;
 - GP i LDK-së, zëvendëskryetarin e parë;
 - GP i Listës serbe, zëvendëskryetarin e dytë;
 - GP i AAK-së, një (1) anëtar, dhe;
 - GP Multietnik, një (1) anëtar.

Në vazhdim, kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri, e ngriti çështjen e interpelancës me ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, z. Hekuran Murati, për çështjen: “Ligji i pagave në sektorin publik”, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me interpelancën e lartshënuar, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, deklaroi se kjo interpelancë do të trajtohet në një rast tjetër, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Helsinki (Finlandë)

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Driton Hyseni dhe Xhavit Haliti u lejohet udhëtimi zyrtar në Helsinki (Finlandë), prej 17 - 21 tetor 2022.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit me tejkalim të tarifës dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. *Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Madrid (Spanjë)*

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Driton Hyseni dhe Xhavit Haliti u lejohet udhëtimi zyrtar në Madrid (Spanjë), prej 18 - 22 nëntor 2022.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit me tejkalim të tarifës dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. *Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel (Belgjikë)*

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Haki Abazi, për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel (Belgjikë), prej 26 - 30 shtator 2022.

Më pas, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, me kërkesën e kryetares së Komisionit për Integrim Evropian dhe për udhëtimet zyrtare të komisioneve parlamentare, diskutuan: nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci; kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca; kryetari i GP të AAK-së, Besnik Tahiri dhe deputetja Eliza Hoxha, përfaqësuese e GP të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, Kryesia në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit prej tre (3) anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, në Bruksel (Belgjikë), prej 26 - 30 shtator 2022.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të transportit, të akomodimit dhe mëditjet për udhëtimin zyrtar nga pika një (1) e këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Kërkohet nga Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë që ta komponojë përbërjen e delegacionit nga pika një (1) e këtij vendimi, për pjesëmarrje në këtë udhëtim zyrtar.

Po ashtu, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, deklaroi se në lidhje me udhëtimet zyrtare, komisioneve parlamentare t'u drejtohet një shkresë me qëllim që udhëtimet zyrtare të realizohen me përfaqësim.

Diskutimi i plotë i kryetarit është i dhënë në transkript.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Poloni

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Haki Abazi, i lejohet udhëtimi zyrtar në Poloni, prej 6 - 9 shtator 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit, tejkalimet e mundshme gjatë organizimit të vizitës dhe mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Kërkesa e deputetit Haki Abazi për mbulimin e shpenzimeve nga udhëtimi në Spanjë dhe Portugali

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Haki Abazi, i mbulohen shpenzimet nga vizitat zyrtare në Spanjë dhe Portugali, sipas kërkesës nr. 08/2409/Do-1009, datë 21. 7. 2022, si në vijim:
 - 1.1. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për datën 6 korrik 2022, si dhe tejkalimet e dokumentuara gjatë vizitës në Spanjë.
 - 1.2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjet për vizitën zyrtare në Portugali, prej 3 - 5 korrik 2022.

6. Rekomandimi i Komisionit ad hoc për shpalljen e konkursit për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa të Mediave

Kryesia, në lidhje me rekomandimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Të shpallet konkursi publik për zgjedhjen e një (1) anëtari të Bordit për Ankesa të Mediave.

2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave ta publikojë konkursin publik nga pika një (1) e këtij Vendimi.

7. Raporti i kryetares së Komisionit për Integrim Evropian lidhur me udhëtimin zyrtar në Pragë (Çeki)

Kryesia është njoftuar me raport me shkrim nga kryetarja e Komisionit për Integrim Evropian, Rrezarta Krasniqi, në lidhje me pjesëmarrjen e saj në Konferencën e Kryetarëve të Komisioneve për Çështjet e Bashkimit Evropian të Parlaenteve të BE-së (COSAC), të mbajtur në Pragë (Çeki), prej 10 - 11 korrik 2022.

8. Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për emërimin e anëtarëve nga ky grup parlamentar në Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit shqiptar

Kryetari konstatoi se propozimi i lartshënuar është konsumuar, pasi Komisioni ad hoc më 27 korrik 2022 e ka proceduar rekomandimin për zgjedhjen e anëtarit të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, përkatësisht e ka përfunduar punën para se Kuvendi të vendosë për propozimin e GP të PDK-së.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa e deputetes Saranda Bogujevci, njëherësh nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe deputetit Avdullah Hoti, për lejimin e udhëtimit zyrtar prej 10 - 18 shtator 2022, në Washington D.C. (Shtetet e Bashkuara të Amerikës)

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Saranda Bogujevci dhe Avdullah Hoti u lejohet udhëtimi zyrtar në Uashington D.C (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), prej 10 - 16 shtator 2022.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit prej 11 - 14 shtator 2022 i mbulon organizatori, ndërsa shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit (me tejkalim) për datat 10, 15 dhe 16 shtator 2022, si dhe shpenzimet e taksës së vizës ose regjistrimit (nëse nga organizatori kërkohen), të testeve COVID-19 (nëse nga organizatori kërkohen) dhe mëditjet për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Kërkesa e deputetes Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit për Integrim Evropian në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Komisionit për Integrim Evropian, prej 26 -29 shtator 2022, në Bruksel (Belgjikë)

Kryesia, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit prej tre (3) anëtarëve të Komisionit për Integrim Evropian, në Bruksel (Belgjikë), prej 26 - 29 shtator 2022.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit (me tejkalim) dhe mëditjet për udhëtimin zyrtar nga pika një (1) e këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Kërkohej nga Komisioni për Integrim Evropian që ta komponojë përbërjen e delegacionit nga pika një (1) e këtij vendimi për pjesëmarrje në këtë udhëtim zyrtar.

Në fund, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, në konsultim me nënkryetarët e Kuvendit dhe me kryetarët dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare të pranishëm njoftoi se seanca plenare më 4 gusht 2022 do të jetë e fundit e Sesionit Pranveror të punimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen në ora 12:29 minuta.

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale